



# KIMI

## KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

PRILL, VITIT MËSIMOR 2020/2021

### UDHËZIME

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË 60 MINUTA

Mos e hapni testin derisa mos t'ju japë leje administruesin i testit.

**Mjetet e lejuara:** lapsi grafit, goma dhe lapsi kimik.

**Punimi i nxënësit duhet të jetë i shkruar me laps kimik.** Vetëm skicat dhe grafikët mund të vizatohen me laps të thjeshtë.

Gjatë provimit lejohet përdorimi i llogaritësit elektronik (digitronit).

**Me kujdes lexoni çdo pyetje.**

**Me vëmendje lexoni udhëzimet të cilat janë të shkruara para çdo grupit të pyetjeve.**

Në detyrat nga 1 deri në 4 rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë. Me rastin e zgjidhjeve të detyrave nga pyetja 5 dhe 6 me kujdes plotësoni tabelën.

Në detyrat nga 7 deri në 15 qartë dhe saktë shkruani përgjigjet në vendin e paraparë për to. Detyrat zgjidhni me ecuri, shkruani drejtë njësitë matëse, kurse vlerat numerike rumbullakojë në dy decimale.

Nëse përgjigjeni në disa mënyra, shënoni mënyrën që dëshironi ta vlerësoi vlerësuesi.

**Detyra do të vlerësohet me 0 pikë nëse:**

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë (grafit)

Nëse gaboni, vijëzojeni përgjigjen e gabuar dhe zgjidhni detyrën përsëri. **Nuk lejohet përdorimi i korrektorit.**

Me test është dhënë edhe Sistemi periodik i elementeve.

**SHIFRA E NXËNËSIT**



1	1,01 <b>H</b> 1	13	10,81 <b>B</b> 5	14	12,01 <b>C</b> 6	15	14,01 <b>N</b> 7	16	15,99 <b>O</b> 8	17	19,00 <b>F</b> 9	18	4,00 <b>He</b> 2	
2	6,94 <b>Li</b> 3	20	26,98 <b>Al</b> 13	28,09 <b>Si</b> 14	30,97 <b>P</b> 15	32,07 <b>S</b> 16	35,45 <b>Cl</b> 17	39,95 <b>Ar</b> 18						
3	22,99 <b>Na</b> 11	24,31 <b>Mg</b> 12	ELEMENTET KALIMTARE											
4	39,10 <b>K</b> 19	40,08 <b>Ca</b> 20	44,96 <b>Sc</b> 21	47,90 <b>Ti</b> 22	50,94 <b>V</b> 23	52,00 <b>Cr</b> 24	54,94 <b>Mn</b> 25	55,85 <b>Fe</b> 26	58,93 <b>Co</b> 27	58,71 <b>Ni</b> 28	63,55 <b>Cu</b> 29	65,39 <b>Zn</b> 30	83,80 <b>Kr</b> 36	
5	85,47 <b>Rb</b> 37	87,62 <b>Sr</b> 38	88,91 <b>Y</b> 39	91,22 <b>Zr</b> 40	92,91 <b>Nb</b> 41	95,94 <b>Mo</b> 42	98,91 <b>Tc</b> 43	101,07 <b>Ru</b> 44	102,91 <b>Rh</b> 45	106,42 <b>Pd</b> 46	107,87 <b>Ag</b> 47	112,41 <b>Cd</b> 48	131,30 <b>Xe</b> 54	
6	132,91 <b>Cs</b> 55	137,33 <b>Ba</b> 56	138,91 <b>La<sup>1</sup></b> 57	178,49 <b>Hf</b> 72	180,95 <b>Ta</b> 73	183,85 <b>W</b> 74	186,21 <b>Re</b> 75	190,23 <b>Os</b> 76	192,22 <b>Ir</b> 77	195,09 <b>Pt</b> 78	196,97 <b>Au</b> 79	200,59 <b>Hg</b> 80	(222) <b>Rn</b> 86	
7	(223) <b>Fr</b> 87	(226) <b>Ra</b> 88	(227) <b>Ac<sup>2</sup></b> 89	(261) <b>Rf</b> 104	(262) <b>Ha</b> 105	266,1 <b>Sg</b> 106	264,1 <b>Bh</b> 107	277 <b>Hs</b> 108	268,1 <b>Mt</b> 109	269 <b>Ds</b> 110	272 <b>Uuu</b> 111	285 <b>Uub</b> 112		
← masa atomike relative ← simboli ← numri rendor														
Lantanoidi <sup>1</sup>														
	140,12 <b>Ce</b> 58	140,91 <b>Pr</b> 59	144,24 <b>Nd</b> 60	145 <b>Pm</b> 61	150,4 <b>Sm</b> 62	151,97 <b>Eu</b> 63	157,25 <b>Gd</b> 64	158,93 <b>Tb</b> 65	162,50 <b>Dy</b> 66	164,93 <b>Ho</b> 67	167,26 <b>Er</b> 68	168,93 <b>Tm</b> 69	173,04 <b>Yb</b> 70	174,97 <b>Lu</b> 71
Aktinoidi <sup>1</sup>														
	232,04 <b>Th</b> 90	231,04 <b>Pa</b> 91	238,03 <b>U</b> 92	(237) <b>Np</b> 93	244 <b>Pu</b> 94	243 <b>Am</b> 95	247 <b>Cm</b> 96	247 <b>Bk</b> 97	251 <b>Cf</b> 98	(254) <b>Es</b> 99	257 <b>Fm</b> 100	258 <b>Md</b> 101	259 <b>No</b> 102	(262) <b>Lr</b> 103

Në detyrat nga 1 deri në 4 rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë.

1. Rretho pohimin i cili NUK është i saktë:  
Metalet alkalino- tokësore:

- A. kanë dy elektrone valentore
- B. janë më të forta se metalet alkaline
- C. oksidet e tyre janë bazike
- D. nuk reagojnë me ujë

2 pikë

2. Renditja e elektroneve në nivelet energjetike për atomin me 13 elektrone është:

- A. K8 L2 M1
- B. K8 L1 M2
- C. K2 L8 M3
- D. K2 L3 M8

2 pikë

3. Rretho pohimin i cili NUK është i saktë:

- A.  $\text{CH}_3 - \text{CH}_2 - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$  emërtohet n-butani
- B.  $\text{CH}_3 - \text{C} \equiv \text{C} - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$  emërtohet 3-pentina
- C.  $\text{CH}_2 = \text{CH} - \text{CH}_2 - \text{CH}_3$  emërtohet 1-buteni
- D. 
$$\begin{array}{c} \text{CH}_3 - \text{CH} - \text{CH}_3 \\ | \\ \text{CH}_3 \end{array}$$
 emërtohet 2-metil propani

2 pikë

4. Ndryshimi kimik i etenit me ujë, në prani të katalizatorit, në temperaturë dhe shtypje të rritur, paraqet reaksionin e:

- A. substituimit
- B. hidrolizës
- C. dehidratimit
- D. adiconit

2 pikë

Në detyrat nga 5 deri në 7 me kujdes plotësoni tabelat.

5. Shkruani X në vendin përkatës në tabelë ashtu që të lidhni emërtimet kimike të komponimeve organike me emërtimet e tyre të rëndomtë.

- |                        |              |
|------------------------|--------------|
| A. acidi etanoik       | 1. alkooli   |
| B. propanoni           | 2. acetoni   |
| C. 1,2,3- propantrioli | 3. uthulla   |
|                        | 4. gliceroli |

Emërtimi kimik i komponimit	Emri i rëndomtë i komponimit			
	1.	2.	3.	4.
A.				
B.				
C.				

2 pikë

6. Shkruani X para pohimit përkatës (e saktë ose e pasaktë). Gazi, oksidi i karbonit (IV) ka këto veti:

POHIMI	Saktë	Pasaktë
A. nuk ka ngjyrë dhe erë		
B. është më i rëndë se ajri		
C. nuk shkakton gulçitje por është helmues		
D. digjet dhe ndihmon djegien		

2 pikë

Në detyrat nga 7 deri në 15 shkruani zgjidhjet në vendin e paraparë për to.

**7.** Cilat jone i japin të gjitha acidet në tretësirë ujore?

Përgjigja: \_\_\_\_\_

1 pikë

**8.** A. Shkruani formulën kimike të sulfatit të bakrit (II)- pentahidrat.

B. Cili është emri i rëndomtë i këtij komponimi?

A. Përgjigja: \_\_\_\_\_

B. Përgjigja: \_\_\_\_\_

2 pikë

**9.** Duke përdorur Sistemin Periodik të Elementeve, përcakto çfarë llojit të lidhjes kimike formon sulfuri me:

A. oksigjen, O \_\_\_\_\_

B. magnez, Mg \_\_\_\_\_

2 pikë

**10.** Shkruani dhe barazoni reaksionin kimik të djegies së pentanit.

Zgjidhja:

2 pikë

**11.** Shkruani formulën strukturore dhe emrin e komponimit i cili formohet me oksidimin e propanalit.


Zgjidhja:

Formula: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

2 pikë	
--------	--

**12.** Shkruani formulën e acidit, bazës dhe kripës ashtu që të përdorni jonet e dhëna:



A. Acidi: \_\_\_\_\_

B. Baza: \_\_\_\_\_

C. Kripa: \_\_\_\_\_

3 pikë	
--------	--

**13.** Shkruani formulën racionale strukturore të metil- etanoatit.

Zgjidhja:

1 pikë	
--------	--

- 14.** Mostra e hekurit ka masë 8 gramë. Llogaritni numrin a atomeve të hekurit në këtë mostër.  
 $A_r(\text{Fe})=56$

*Të paraqitet procedura e zhvillimit të detyrës.*

**Zgjidhja:**

2 pikë	
--------	--



**15.** Sa gramë kripë dhe sa gramë ujë duhet peshuar për përgatitjen e 150 g tretësire me pjesëmarrje në masë 0,20?

*Të paraqitet procedura e zhvillimit të detyrës.*

**Zgjidhja:**

3 pikë	
--------	--





**E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM**

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: \_\_\_\_\_

Nota: \_\_\_\_\_

**KOMISIONI:**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**VLERËSUESI KRYESOR:** \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ 2021